

N r. R e n d o r	Data e regjistrimit	Objekti	Data e kthimit të përgjigjes	Përmbajtja e përgjigjes	Mënyra e përfundimit të kërkesës (E plotë/ E kufizuar/ E refuzuar/ E deleguar)	Tarifa e shërbimit
Periudha Janar- Dhjetor 2022						
1	13.01.2022	Kërkesë për informacion ardhur nga një gazetare dhe referuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë në lidhje me shtesat mbi pagën të policisë së burgjeve.	14.01.2022	<p>Përhëndetje Znj. Allkanjari, Lidhur me sa kerkoet ju informojme se: Për sa i përket tre pyetjeve tuaja në lidhje me shtesat mbi pagat, informacioni i kërkuar mund të gjendet në Vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) me Nr. 920, Datë 25.11.2020 "Për trajtimin me paga e shtesa mbi pagë dhe për procedurën e kompensimit financiar gjatë qëndrimit në punë të punonjësve të policisë së burgjeve", i aksesueshëm që nga botimi në fletoren zyrtare të vitit 2020. Për orientimin tuaj:</p> <p style="text-align: center;">-Sa është % që përfitojnë punonjësit e policisë së burgjeve në shtesën për gradë? Sa është konkretisht për secilën gradë?</p> <p>Në kreun 1, pika 1/a, VKM-ja parashikon se: "Paga bazë mujore për gradë, që është niveli i pagës së punonjësit në përputhje me gradën që ka fituar brenda rolit përkatës. Vlera e pagës bazë mujore për gradë përcaktohet në lidhjen nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij." Për tu njohur konkretisht me pagat bazë për gradë dhe rrjedhimisht, "shtesave" për gradë, referojuni kësaj lidhjeje.</p> <p style="text-align: center;">-Si përllorarit shtesa e pagës për vjetërsi pune te punonjësit e policisë së burgjeve? Sa është shtesa në % dhe sa përfitojnë konkretisht?</p> <p>Në kreun 1, pika 1/c, VKM-ja parashikon se: "Shtesa për vjetërsi në shërbim, që është shtesa që përfiton punonjësi i Policisë së Burgjeve me grada, për kohën e qëndrimit në gradë, në masën 1 për qind, pas çdo viti pune. Llogaritja e shtesës për vjetërsi shërbimi bëhet mbi pagën e gradës "Nëninspektor", të rolit bazë". Më tej në pikën 2 dhe 3 të kreut të parë parashikohen rregullat për përlloraritjen e vjetërsisë në punë: "2. Për efekt të llogaritjes së shtesës për vjetërsi në shërbim, sipas shkronjës "c", të pikës 1, të këtij kreu, konsiderohen vitet e qëndrimit në gradë të dokumentuara në librezën e punës së çdo punonjësi në strukturat e Policisë së Burgjeve, Policisë së Shtetit, Forcave të Armatosura, Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat dhe Shërbimit Informativ të Shtetit, sipas ekuivalentimit në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave. 3. Vitet që përjashtohen nga llogaritja e shtesës së vjetërsisë së shërbimit vetëm për efekt pagese janë vitet e sigurimit vullnetar, të vetëpunësimit, vitet e punës si punonjës pa gradë, vitet e shërbimit ushtarak për meshkujt, vitet e shkollimit në institucionet e arsimit ushtarak të Ministrisë së Brendshme, të Ministrisë së Drejtësisë dhe të Ministrisë së Mbrojtjes, si dhe periudhat e trajtimit me pagesë papunësie apo pagesë kalimtare."</p> <p style="text-align: center;">-Në vitin 2022 punonjësit e policisë së burgjeve do të përfitojnë shtesë për kushte pune. Sa do të jetë shtesa dhe si do të përllorarit?</p> <p>Në kreun 1, pika 1/b, VKM-ja parashikon se: "Shtesa për natyrë të veçantë pune, që është shtesa për shkak të natyrës së punës, për kohën që ushtrojnë detyrat funksionale, (sipas funksioneve/pozicioneve të miratuara në organikë) dhe që përcaktohet: -në lidhjen nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, në institucionet e administrimit të vendit, -në lidhjen nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, në punonjësit e Policisë së Burgjeve."</p>	E plotë	Nuk ka
2	13.01.2022	Kërkesë për informacion me email, nga një individ, në lidhje me eksperiencën e tij të punës në Administratën Shtetërore.	20.01.2022	<p>Në përgjigje të kërkesës suaj sqarojmë se referuar gërmës f, të pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, Departamenti i Administratës Publike (DAP) siguron mirëadministrimin e shërbimit civil me institucionet e administratës shtetërore, që në kuptim të nenit 4 të ligjit 90/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", përfshin : a) Kryeministria b)Ministrinë c) institucionet në varësi të kryeministrit dhe ministrave c) njësitë e drejtëpërdrejta të ofrimit të shërbimeve d) agjencitë autonome dh) administrata e prefektit. Sjellim në vëmendjen tuaj se, për çdo punëmarrës në Republikën e Shqipërisë, dokumenti zyrtar që vërteton eksperiencën në punë si dhe fushën e punësimit është librezja e punës. Nderkohë bazuar në nenin 35 të Kodit të Punës, i ndryshuar, për llojin, natyrën dhe kohëzgjatjen e punës mund t'i kërkonte punëmarrësit të pajiseni me vërtetimin e punës.</p>	E plotë	Nuk ka
3	04.02.2022	Kërkesë nga një individ, në lidhje me periudhën e provës në shërbim civil ardhur si kërkesë për informacion.	14.02.2022	<p>Kërkesa trajtuar jashtë objektit të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", pasi kërkohej njohja e periudhës së provës në shërbim civil.</p>	E plotë	Nuk ka

4	10.02.2022	Kërkesë për informacion nga një individ, në lidhje me marrjen e një kopje të një shkrese.	17.02.2022	Në përgjigje të shkresës tuaj, në zbatim të nenit 3 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", gjeni bashkëlidhur shkresën nr. 6558 prot., datë 20.12.2021, të Ministrit të Kulturës me lëndë "Kërkesë për lirin e Anëtarit të Trupës së Nivelit të Lartë Drejtues nga një pozicion i rregullt drejtues", protokolluar pranë Departamentit të Administratës Publike me nr. 7231 prot., datë 24.12.2021, në vijim të së cilës, DAP ka nxjerrë aktin e liritimit nga pozicioni Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Kulturës, në ministrinë e Kulturës, të z. Gjet Ndoj. Duke ju falenderuar për mirëkuptimin.	E plotë	Nuk ka
5	21.02.2022	Kërkesë me e-mail, nga një individ, në lidhje me një rast konflikt interesi ardhur si kërkesë për informacion.	25.02.2022	Kërkesa trajtuar jashtë objektivit të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", pasi kërkohej trajtimi i një rasti konflikt interesash.	E plotë	Nuk ka
6	23.03.2022	Kërkesë për informacion me shkresë zyrtare, nga një individ, në lidhje me fillimin e një procedure disiplinore	05.04.2022	Përgjigja nr.1 bashkëlidhur.	E plotë	Nuk ka
7	23.03.2022	Kërkesë për informacion me shkresë zyrtare, nga një individ, në lidhje me një masë disiplinore të dhënë	05.04.2022	Përgjigja nr.2 bashkëlidhur.	E plotë	Nuk ka
8	11.05.2022	Kërkesë për informacion me e-mail, nga një individ, në lidhje me statusin e një kërkesë të mëparshme drejtuar Departamenti t të Administratës Publike	26.05.2022	Kërkesa trajtuar duke e vënë në dijeni personin për numrin e protokollit dhe datën e shkresës, me të cilën është kthyer përgjigje.	E plotë	Nuk ka
9	17.05.2022	Kërkesë me e-mail, nga një individ, në lidhje me studentët e ekselencës të punësuar në shërbim civil.	01.06.2022	Përgjigja nr. 3 bashkëlidhur.	E plotë	Nuk ka

10	26.07.2022	Kërkesë nga një individ, në lidhje me procesin e dekriminalizimit për vitin 2016.	15.08.2022	Përgjigja nr. 4 bashkëlidhur.	E pjesshme	Nuk ka
11	08.08.2022	Kërkesë me e-mail, nga një individ, në lidhje me një testim me shkrim.	11.08.2022	Përsëndetje z. Gjini, Në vijim të email-it tuaj, përmes të cilës kërkonti vënie në dispozicion të dokumentacionit/tezës me shkrim të zhvilluar në kuadër të procedurës së rekrutimit #4079-Lloji i diplomës "Arsim i Lartë Ushtarak/Policor/Shkenca Ekonomike/Juridike", niveli minimal i diplomës "Master Profesional", ju bëjmë me dije se mund të paraqiteni në çdo kohë pranë ambienteve të Departamentit të Administratës Publike për t'u njohur me dokumentet e kërkuara. Në kohë të shpejtë në vëmendjen tuaj se, ky lloj aksesi në informacion/dokumentacion publik garanton të drejtën e individit për informacion dhe dokumentacion, është në përputhje me legjisllacionin e zbatueshëm në fuqi, si dhe jurisprudencën e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, Vendimi nr. 3085, datë 25.11.2020. Duke ju falenderuar për mirëkuptimin.	E plotë	Nuk ka
12	10.08.2022	Kërkesë me e-mail, nga një gazetar, në lidhje me emërimin e një nëpunësi civil.	19.08.2022	Përsëndetje, Në përgjigje të kërkesës tuaj të datës 10.08.2022, dërguar pranë Departamentit të Administratës Publike (DAP), në adresën elektronike info@dap.gov.al, ku bazuar në ligjin nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit", kërkonti informacion në lidhje me emërimin e nëpunësit civil z. A. H., ju bëjmë me dije si vijon: Nga të dhënat e administruara pranë Departamentit të Administratës Publike, rezultojnë se nëpunësi civil z. A. H., nëpërmjet aktit të transferimit të përhershëm për shkak të ristrukturimit të institucionit, me nr. 2830/112 prot., datë 15.07.2020, është transferuar në pozicionin Inspektor i Parë në Sektorin e Kontrollit në Vend sipas Industrive, në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor, në Drejtorinë e Tatimpaguesve të Mëdhenj- kategoria e pagës III-b. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, në zbatim të Kodit të Procedurave Administrative, me shkresën nr. 13713/1 prot., 20.07.2020, ka bërë ekzekutimin e detyrueshëm të aktit administrativ të mësipërm duke lidhur marrëdhëniet financiare në pozicionin Inspektor i Parë, në Sektorin e Kontrollit në Vend sipas Industrive, në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor, në Drejtorinë e Tatimpaguesve të Mëdhenj, kategoria e pagës III-b. Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!	E plotë	Nuk ka
13	15.08.2022	Kërkesë me e-mail, nga një individ, në lidhje me një procedurë rekrutimi.	15.08.2022	Përsëndetje z.Gjini, Në përgjigje të email-it tuaj, ju bëjmë me dije si vijon: Me shpalljen #3851- Lloji i diplomës "Shkenca Ekonomike/Juridike/Inxhinierike", niveli minimal i diplomës "Master Shkencor", DAP ka publikuar 4 pozicionet vakante të mëposhtme: Specialist në Sektorin e Monitorimit të Rrjetit Antikorrupsion, në Drejtorinë e Rrjetit të Koordinatorëve Antikorrupsion, në Drejtorinë e Përgjithshme të Antikorrupsionit, në Ministrinë e Drejtësisë - kategoria: III-b (Shkenca Ekonomike/Juridike/Inxhinierike) Specialist në Sektorin e Monitorimit të Rrjetit Antikorrupsion, në Drejtorinë e Rrjetit të Koordinatorëve Antikorrupsion, në Drejtorinë e Përgjithshme të Antikorrupsionit, në Ministrinë e Drejtësisë - kategoria: III-b (Shkenca Ekonomike/Juridike/Inxhinierike) Specialist në Sektorin e Monitorimit të Rrjetit Antikorrupsion, në Drejtorinë e Rrjetit të Koordinatorëve Antikorrupsion, në Drejtorinë e Përgjithshme të Antikorrupsionit, në Ministrinë e Drejtësisë - kategoria: III-b (Shkenca Ekonomike/Juridike/Inxhinierike) Specialist në Sektorin e Monitorimit të Rrjetit Antikorrupsion, në Drejtorinë e Rrjetit të Koordinatorëve Antikorrupsion, në Drejtorinë e Përgjithshme të Antikorrupsionit, në Ministrinë e Drejtësisë - kategoria: III-b (Shkenca Inxhinierike). Në përfundim të procedurave të konkurrimit, nga 4 pozicione vetëm 3 pozicione janë plotësuar me kandidatë fitues. Në kohë të shpejtë nga të dhënat që administrojmë, në Sektorin e Monitorimit të Rrjetit Antikorrupsion, në Drejtorinë e Rrjetit të Koordinatorëve Antikorrupsion, në Drejtorinë e Përgjithshme të Antikorrupsionit, në Ministrinë e Drejtësisë - kategoria: III-b, janë aktualisht dy pozicione vakante, një pozicion i cili nuk u plotësua pas përfundimit të procedurave të konkurrimit të shpalljes së sipërpërmendur dhe vakanca tjetër është krijuar pas miratimit të planit vjetor të pranimit në shërbimin civil për vitin 2022. Sa më sipër, DAP do vijojë me shpalljen e vakancave në respektim të planit vjetor të pranimit në shërbimin civil për vitin 2022 dhe kërkesave të institucioneve. Për të marrë informacion mbi publikimin e vendeve vakante për të cilat plotësoni kriteret e përgjithshme dhe ato të posaçme, lutemi të vizitoni herë pas here faqen tonë zyrtare www.dap.gov.al. Duke ju falenderuar për mirëkuptimin.	E plotë	Nuk ka

14	15.08.2022	Kërkesë me e-mail, nga një individ, në lidhje me studentët e ekselencës.	25.08.2022	<p>Përsëritje,</p> <p>Në përgjigje të kërkesës suaj të datës 15.08.2022 për informacion dhe dokumentacion, ju bëjmë me dije si vijon: Së pari, referuar kërkesës suaj për vënien në dispozicion të dokumenteve të plota me anë të cilave Departamenti i Administratës Publike ka shprehur mendime lidhur me VKM-në nr. 160/2020 "Për mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer dhe të nëpunësve civilë (Fondi i Ekselencës)", dhe versionet e projekt VKM-së mbi të cilat i ka shprehur mendimet vlerësojmë t'ju informojmë se në zbatim të gërmës a, të pikës 1, të nenit 67, të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat", leja për shfrytëzim të parakohshëm të dokumenteve, që u kufizohet shërbimi në nenet 61, 62 dhe 63 të këtij ligji, jepet përkatësisht nga fondkrijuesi, i cili në këtë rast është Ministria e Arsimit dhe Sportit. Për këtë arsye i gjithë informacioni që kërkoni gjendet i plotë pranë tyre.</p> <p>Së dyti, lidhur me pikën ku ju kërkoni t'ju vendosim në dispozicion numrin e "përfituesve të Fondit të Ekselencës" të cilët janë punësuar nga DAP (sipas VKM-së nr. 160/2020) nëpërmjet programit të punësimit të përkohshëm të VKM-së nr. 586/2019, institucionin në të cilin këta përfitues janë diplomuar, institucionin në të cilin janë punësuar dhe kohëzgjatjen e punësimit, ju bëjmë me dije se jeni informuar edhe nëpërmjet komunikimit elektronik të datës 17.05.2022.</p> <p>Vlen t'ju informojmë se DAP disponon listat e përfituesve sipas VKM-së nr. 586/2019, ku klasifikimi bëhet sipas metodologjisë së përcaktuar në këtë akt nënligjor. Sa i takon përfituesve të Fondit të Ekselencës sipas VKM-së nr. 160/2020 siç jeni në dijeni edhe nga komunikimet e mëparshme, meqënëse referohet për zbatim mbi VKM-në nr. 586/2019 këta përfitues ndjekin të gjitha procedurat e parashikuara nga ky akt i fundit nënligjor. Për rrjedhojë DAP disponon vetëm listat e kandidatëve përfitues sipas VKM-së nr. 586/2019, të cilat i gjeni bashkëngjitur email-it. Më konkretisht:</p> <p>Listën me pozicionet e punës dhe pikët për secilin kandidat të punësuar nga thirrja "Gati për Shqipërinë", sipas pikës 3 referuar kërkesës suaj. Listën paraprake të kualifikimit, listën pas ankimit administrativ si edhe listën me përzgjedhjen përfundimtare për secilën thirrje sipas pikës 4 referuar kërkesës suaj. Duke ju falënderuar për mirëkuptimin!</p> <p>Listat në përgjigjen nr. 5 bashkëlidhur.</p>	E plotë	Nuk ka
15	E-maili rikuperuar pas sulmit kibernetik	Kërkesë me e-mail, nga një individ, në lidhje me reformën në administratën publike.	15.09.2022	Përgjigja nr. 6 bashkëlidhur.	E plotë	Nuk ka
16	20.09.2022	Kërkesë me e-mail, nga një individ, në lidhje me një procedurë rekrutimi.	04.10.2022	Përgjigja nr. 7 bashkëlidhur.	E plotë	Nuk ka
17	24.10.2022	Kërkesë me e-mail, nga një individ, në lidhje me një nëpunës civil.	04.11.2022	<p>Në përgjigje të kërkesës tuaj të datës 24.10.2022, dërguar pranë Departamentit të Administratës Publike (DAP), në adresën elektronike info@dap.gov.al, ku bazuar në ligjin nr. 119/2014, "Për të Drejtën e Informimit", kërkoni informacion në lidhje me nëpunësin civil znj. Elidjana Çelaj, ju bëjmë me dije se:</p> <p>Nga të dhënat e administruara pranë Departamentit të Administratës Publike, rezultojnë se nëpunësi civil znj. Elidjana Çelaj, nëpërmjet aktit të emërimit, me nr. 1039 prot., datë 14.02.2022, është emëruar në pozicionin Zëvendësdyrëtor i Përgjithshëm i Hartimit të Programeve, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve- kategoria II-b. Për sa më sipër dhe në vijim të kërkesës suaj i jemi drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, të cilët me e-mailin e datës 02.11.2022 na kanë informuar se për shkak të vakancës së pozicionit të punës, rëndësise se tij dhe arritjes së objektivave të Drejtorisë Rajonale, me Urdhërin nr. 44, datë 05.04.2022, të Titullarit të Institucionit, znj. Elidjana Çelaj është ngarkuar të kryejë detyrën e Drejtorit Rajonal deri në momentin e përfundimit të procedurës së shpalljes së pozicionit vakant Faleminderit për mirëkuptimin.</p>	E plotë	Nuk ka

18	24.10.2022	Kërkesë me e-mail, nga një individ, në lidhje me anëtarët e një Komisioni Disiplinor.	04.11.2022	<p style="text-align: center;">Përhëndetje,</p> <p>Në përgjigje të kërkesës tuaj të datës 27.10.2022, dërguar pranë Departamentit të Administratës Publike (DAP), në adresën elektronike info@dap.gov.al, ku bazuar në ligjin nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", kërkoni informacion në lidhje me anëtarët e Komisionit Disiplinor, të ngritur pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, ndaj znj. Shilda Hasanaj (Kamberi), ju informojmë se:</p> <p>Në urdhrin nr. 92, datë 03.08.2022 "Për ngritjen e Komisionit Disiplinor" dhe urdhrin nr. 92/1, datë 19.08.2022 "Për një ndryshim në urdhrin nr 92, datë 03.08.2022 Për ngritjen e Komisionit Disiplinor" të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, janë përcaktuar shprehimisht se cilët janë anëtarët e komisionit disiplinor të ngritur ndaj znj. Shilda Hasanaj dhe rolin që ata kanë në këtë procedurë.</p> <p style="text-align: center;">Konkretisht, përbërja e këtij Komisioni Disiplinor është përcaktuar si më poshtë: Znj. Elidjana Çelaj, në cilësinë e nëpunësit më të lartë civil Z. Ceno Klosi, në cilësinë e eprorit direkt të znj. Shilda Hasanaj Z. Ilir Kurti, në cilësinë e drejtuesit të burimeve njerëzore Z. Naim Mete, në cilësinë e nëpunësit më të vjetër civil, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve Znj. Migena Leka, në cilësinë e përfaqësuesit të Departamentit të Administratës Publike</p> <p>Për më tepër, në lidhje me pyetjen e ngritur nga ana juaj për institucionin ku duhet të ngrihet Komisioni Disiplinor, ju bëjmë me dije se referuar nenit 7, të ligjit 90/2012 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore" Drejtoritë Rajonale Tatimore do të konsiderohen si degë territoriale të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe si pjesë e strukturës të këtij institucioni.</p> <p>Në përgjigje të pyetjes tuaj se cilët do të konsiderohen nëpunësit më të lartë civilë në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, nga të dhënat e administruara pranë Departamentit të Administratës Publike rezultojnë se, në strukturën e DPT-së, nëpunësit më të lartë civilë janë znj. Boriana Shaka, emëruar në pozicionin e Zv. Drejtorit të Përgjithshëm të Funksioneve Operacionale në datën 21.02.2022 dhe znj. Elidjana Çelaj, emëruar në pozicionin e Zv. Drejtorit të Përgjithshëm të Hartimit të Programeve në datën 14.02.2022.</p> <p>Për sa i përket pyetjeve tuaja në lidhje me përcaktimin e eprorit direkt të znj. Shilda Hasani, ju bëjmë me dije se pika e, neni 4, e ligjit 152/2013 "Për nëpunësin civil" përcakton eprorin direkt për çdo nëpunës civil.</p> <p>Në këto kushte, në ecurinë disiplinore në fjalë, në cilësinë e eprorit direkt është caktuar z. Ceno Klosi, me detyrë Drejtorin e Përgjithshëm të Tatimeve. Në lidhje me pyetjen tuaj për nëpunësit më të vjetër civilë të DPT-së, ju duhet t'i drejtoheni burimeve njerëzore pranë këtij institucioni, të cilët kanë detyrimin për të krijuar dhe administruar dosjen e personelit të çdo të punësuarit në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.</p> <p style="text-align: center;">Faleminderit për mirëkuptimin</p>	E pjeshme	Nuk ka
----	------------	---	------------	--	-----------	--------